



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 27.10.2022, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi kërkesën e deputetes znj. Jorida Tabaku për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të bordit të ERE-s nr. 242, datë 23.09.2022, “Mbi kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a., lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë për klientët familjarë me konsum mbi 800 kWh në muaj”.
2. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës të ALPEX sh.a. dhe të OST sh.a., për miratimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike (rregullat e ALPEX, përkufizimet, procedura e tregtimit, si dhe procedura e kërimit dhe shlyerjes), si dhe anulimin e rregullave të tregtimit, termat e përgjithshme, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 214, datë 28.12.2017.
3. Mbi miratimin e kontratës ndërmjet shoqërive KESH sh.a. dhe FTL sh.a. për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.
4. Mbi miratimin e kontratës tip për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti (KESH sh.a.) dhe furnizuesi i shërbimit universal (FSHU sh.a.), për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a., për periudhën kohore 01.01.2022 - 31.12.2022.
5. Mbi licencimin e shoqërisë “H&K@Vala Mar Residences” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “BIGWIND” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në fshatin Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier.
8. Mbi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të bordit të ERE-s më datë 14.10.2022 dhe datë 17.10.2022.